



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC



Më
Dana

27 - 12 - 2018

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:012076
Datë: 13.09.2018
Numri i dokumentit: 00120884

P.nr.511/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-
Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi, me procesmbajtësen Mimoza
Shabani, bashkëpunëtore profesionale, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga
Fsh. [REDACTED] Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga
neni 320 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2252-1/15
të datës 26.08.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik në praninë e përfaqësuesit
të akuzës prokurorit të shtetit Albert Zajnullahu, përfaqësuesit juridik të KEDS-it në Ferizaj,
[REDACTED], si dhe të pandehurit [REDACTED], më datë 14.08.2018 mori dhe publikisht
shpalli, ndërsa me datë 28.08.2018 përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri: [REDACTED] i lindur më [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] Komuna e Ferizajt,
nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka të kryer shkollën fillore, i martuar, prind i
tre fëmijëve, me profesion automekanik, me nr. personal [REDACTED], gjendjes së dobët
ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse prej datës së pavërtetuar deri më datë 14.08.2015, në Fsh. [REDAKTUAR] K. Ferizaj, gjatë kontrollit të njësorit elektrik me nr.17673277 nga ana e punëtorëve të autorizuar të Qendrës së Kalibrimit në Prishtinë, është konstatuar duke përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme shërbimet komunale për vete, në atë mënyrë që ka bërë ndërhyrje të paautorizuara në njësorin elektrik, ashtu që njësori pllombat shtetërore i ka të manipuluar, të hapura dhe prapë të mbyllura, sistemi i fazës së parë R është i djegur, me ç'rast energjia e shpenzuar është regjistruar në njësorë për 33.33 % më pak, në brendi të njësorit numëruesi është manipuluar, ka gjurmë të gërvishitjes së numrave në numërorë dhe atë shifra tretë nr.0, shifra e katër nr. 1.2.3.5, shifra pestë nr.1 në T1, shifra e dytë nr. 9.0, shifra e tretë nr. 4.5, shifra e katër nr. 1.2 dhe shifra e pestë nr. 8.9 në T2, me të cilin veprim ka dëmtuar KEDS-in në shumë prej 1.735.25 € (njëmijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë euro e njëzetë e pesë cent).

me të cilën kreu veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe nenit 4,7,21,41,42, 46, 50,51, 74,75 dhe 76 të KPRK-së dhe nen. 365 të KPPRK-së, të pandehurin [REDAKTUAR] e:

GJYKON

I. DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej 4 (katër) Muaj dhe të njëjtin dënim urdhëron që mos të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën kohore prej 1 /një/ viti, pasi ky aktgjykim të marrë formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale,

dhe

II. DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 300 € (treqind euro), të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 Euro do të vuaj nga një ditë burgimi.

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Ferizaj, në emër të kërkesës pasurore juridike t'i kompensoj shumën në vlerë prej 1.735.24, në emër të dëmit të shkaktuar, në afat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjithashtu obligohet i akuzuari në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2252-1/15 të datës 26.08.2015 i ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje si dhe duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Gjykata Themelore në Ferizaj, fillimisht ka caktuar seancë e shqyrtimit gjyqësor më datë 14.08.2018, në të cilën Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë akuzës për të pandehurin duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ti shqipton një sanksion sipas ligjit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit-KEDS me seli në Ferizaj, [REDAKTUAR] në seancën e shqyrtimit gjyqësorë i është bashkangjitur ndjekjes penale për të pandehurin dhe njëkohësisht ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Avokati mbrojtës i të pandehurit [REDAKTUAR] Av. [REDAKTUAR], në fjalën hyrëse ka deklaruar se aktakuza nuk qëndron e bazuar, duke i krahasuar shpenzimet e energjis elektrike prej vitit 2014 deri me 18.08.2018, shifet se absolutisht nuk ka ndryshim të shpenzimit si para ashtu edhe pas kalibrimit, nga kjo evidencë nuk kemi rritje apo nga të njëjtat nuk mund të konstatohet se kemi humbje siç parashihet në procesverbalin me rastin e kalibrimit të njehsorit elektrik kur thuhet se shpenzimet e energjisë elektrike janë regjistruar 33.33 % më pak. Shtrohet pyetja si është e mundur të rikthehet humbja në shumën 1735.24 euro kur pas kalibrimit të njehsorit nuk kemi rritje as për 0.1%. Vlen të ceket fakti se në punëtorin nuk ka energji të nivelit të duhur që të mund të shfrytëzohet për përdorimin e teknikës nga i akuzuari, i akuzuari nuk mund të përdor as aparatit e saldimit, të tthisha shpenzimet e saldimit i kryen me oksigjen, nuk përdor asnjë aparat tjetër e cila ka të bëjë me shpenzim të energjisë, andaj kjo aktakuzë nuk është e qëndruar dhe i propozoj gjykatës ta hudhë.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit gjyqësor në mbrojtjen e tij ka deklaruar se është pronar i lokalit i cili gjendet në fshatin [REDAKTUAR] (ish [REDAKTUAR]) ku punon së bashku me vëllain e tij, duke theksuar se është përgjegjës dhe e menaxhon punën në këtë lokal si auto servisë i traktorëve. Ka shtuar se i është ndërruar njësori dhe i është vendosur njësori dixhital, pas dy apo tre ditësh në prezencën e tij punëtorët e KEDS-it, kanë bërë regjistrimin e pajisjeve elektrike.

Gjithashtu i pandehuri në mbrojtjen e tij ka deklaruar se në punëtorinë e tij ka vetëm një vinq, një kompresor dhe tre poqa elektrik, duke shtuar se asnjëherë nuk ka keqpërdorë energjinë elektrike dhe se nuk e din se si ka ndodhur që ky njësor elektrik të jetë manipuluar. Nuk e ka mohuar faktin ti ketë pasur borxh kompanisë KEDS afërsisht 700 €, por më vonë pas vendosjes së njehsorit elektrik borxhi ka arritur në lartësi prej 2.214 €. I pandehuri më tutje në mbrojtjen e tij pohuar se nga viti 2010e ka në posedim dhe shfrytëzim lokalit auto-mekanik në Fsh. [REDAKTUAR] me veprimtari të riparimit të traktorve dhe mjeteve të rënda, vendin e ka marrë me qira nga Pyllltaria e Kosovës dhe vetë ka ndertu objektin apo punishten, shpesh i ka rastit ti thehet nga hajnat dhe kryesisht i janë marrë çelsa, prerëse, burmashina etj., pagesën e energjisë e ka bërë rregullisht si me orë të re ashtu edhe me orë të vjetër pagesën e ka pasur të njëjtë siç

ka pasur raste kur ka paguar nje muaj 5 euro, një muaj 8 euro, mjetet e punës që ka në garazhdë nuk mund ti shfrytëzon pasi që tensioni i rrymës është i dobët.

Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas kësaj akuze, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetoi gjendjen e fakteve të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike para së gjithash gjykata e vërtetoi nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësorë i cili ka deklaruar se është punëtor i KEDS-it, përkatësisht në Qendrën e Kalibrimit në Prishtinë si teknik i kontrollit dhe verifikimit të njësorëve elektrik, ndërsa sa i përket rastit konkret ka theksuar se së bashku me kolegët e tij [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kanë marrë pjesë në kontrollin detal të njësorit elektrik me nr.17673277 dhe me rastin e kontrollit kanë konstatuar se: njëtori elektrik, blloibat e prodhuesit i ka pasur të manipuluar të hapura dhe prap të mbyllura, nga ana e jashtme njësorit nuk i vërehen dëmtime tjera.¹ Njëtori elektrik në fjalë është tre fazor dhe I ka tri bubina të tensionit dhe të rrymës, bubina e parë quhet R është e djegur, bubina e dytë quhet S dhe bubina e tretë quhet T, në këtë njëtori bubina e parë R ka regjistruar energji elektrike për 33.33% më pak, kjo është vërtetuar me instrumentin matës të bubinave.

Gjykata vlerëson se dëshmia e dëshmitarit është e besueshme dhe bindëse, për faktin se i njëjti ka vepruar si një nga anëtarët e komisionit për kontrollimin e njësorit elektrik dhe në mënyrë profesionale ka elaboruar faktin se njëtori elektrik që është objekt i aktakuzës është manipuluar, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë apo motiv të dëshmitarit në raport me të pandehurin rreth dëshmisë së tij që do ta vinte në pikëpyetje dëshminë e tij.

Për më tepër dëshmia e dëshmitarit përputhet edhe me procesverbalin nr.02/14 të datës 14.08.2015, të përpiluar nga komisioni prej tre anëtarëve nga Departamenti AMR e Kalibrimit në kuadër të KEDS-it, në të cilin është konstatuar mes tjerash se njëtori elektrik me nr.17673277, pllombat e prodhuesit i ka të manipuluar, të hapura dhe të mbyllura, me ç'rast në aspektin objektiv gjykata konstaton se është kryer vepra penale siç përshkruhet në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

¹ Shih dëshminë e plotë të dëshmitarit në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësorë.

Po ashtu edhe në aspektin subjektiv rezulton se i pandehuri [REDAKTUAR] ka kryer këtë veprë penale, kjo bazuar pjesërisht edhe në vet mbrojtjen e tij dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësorë i cili ka pranuar faktin se është përgjegjës dhe njëherë edhe menaxher i lokalit në të cilin ndodhet njëtori. Ndërsa sa i përket pohimit të pandehurit, tekstualisht *“nuk e ka keqpërdorë energjinë elektrike dhe nuk e di se si ka ndodhur që ky njëtor është manipuluar”* për gjykatën ky pohim është i pa pranueshëm dhe nuk mbështetet me asnjë provë të vetme sikundër që është e pa logjikshme që ndokush tjetër të ketë qasje në njëtorë elektrik pa dijeninë e tij, si rrjedhojë askush nuk do të kishte ndonjë interes për të manipuluar njëtorin elektrik të pandehurit.

Andaj, Gjykata vlerësuar në aspektin juridik konstatoi se për të pandehurin përmbushen gjitha tiparet objective dhe subjective të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 320 të KPRK-së, kjo për faktin se i pandehuri në kohën dhe vendin e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me qëllim përfimiti ka manipuluar njëtorin elektrik pa autorizimin e furnizuesit, andaj në rastin konkret kumulativisht janë përmbushur gjitha elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit të përcaktuara në nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, si rrethana lehtësuese gjykata mori fillimisht rrethanat e tij familjare, i njëjti është i martuar, babë i tre fëmijëve, gjendja jo e mirë ekonomike, nuk ka dëshmi se është gjykuar me vendim të forms së prerë. Ndërsa në mungesë të rrethanave veçanarisht rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i vërtetoi dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 /katër/ muaj, i cili dënim nuk do të ekezutohet në periudhën kohore prej 1 /një/ vit nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale, dhe dënim me gjobë efektiv në lartësi prej 300 Euro (treqind euro) në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku dënimet e tilla janë adekuate dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjesë së vepres penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës KEDS- Distrikti në Ferizaj - t'i kompensoj shumën në vlerë prej 1735.24 €. në emër të dëmit të shkaktuar, në afat prej 30 ditëve nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Numri i lëndës: 2018:012076
Datë: 13.09.2018
Numri i dokumentit: 00120884

Gjithashtu obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €/tridhjetë/, në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.511/18 të dt. 28.08.2018

B. Profesionale
Mimoza Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE -- Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.